



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 334/6 prot.

Tiranë, më 30.04.2021

VENDIM

Nr.47, datë 30.04.2021

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT
TË KOMISIONERIT NR. 16, DATË 24.02.2021**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 16, datë 24.02.2021, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë të procedurës së lirimit nga shërbimi civil për shkak të ligjit, të nëpunësit *****”, në detyrën “Specialist Auditi”*.

KONSTATOVA SE:

Me anën e kërkesës së regjistruar me nr. regjistruar me nr. 933 prot., datë 21.12.2020 *“Kërkesë për interpretim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe asaj me nr. 933/1 prot., datë 31.12.2020, “Dërgim dokumentacioni”, ka ngritur disa pretendime për parregullsi dhe shkelje në zbatimin e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë kryerjes së procesit administrativ të lirimit të tij nga detyra dhe përfundimit të marrëdhënies së punësimit, komunikuar me vendimin nr. 33, datë 01.09.2020, “Për lirimin nga shërbimi civil i nëpunësit civil *****”, të Kryetarit të Bashkisë Maliq.*

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti, duke kërkuar nga institucioni i Bashkisë Maliq të dërgojë të gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me këtë rast.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 16, datë 24.02.2021 të Komisionerit, “*Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë të procedurës së lirit nga shërbimi civil për shkak të ligjit, të nëpunësit *****, në detyrën “Specialist Auditi”.*”

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Maliq ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në vendimin nr. 16, datë 24.02.2021 si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil për rastin në fjalë në institucionin e Bashkisë Maliq paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse në Bashkinë Maliq, për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë, të veprjës sipas masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit nr. 16, datë 24.02.2021, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Konkretisht, Komisioneri ka kërkuar nga njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Maliq që të anulojë si të paligjshëm aktin administrativ nr. 33, datë 01.09.2020, për lirin nga shërbimi civil të nëpunësit *****, me një akt të ri me shkrim, për shkak se përbën ushtrim të diskrecionit në mënyrë jo të ligjshme dhe se vjen në kundërshtim me përmbajtjen e ligjit material e atij procedural. Njëkohësisht, të urdhërohet rikthimi i nëpunësit në fjalë në pozicionin e tij të mëparshëm të punës “*Nëpunës Auditi*”, në Sektorin e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Maliq, duke i sugjeruar të bëjë një kërkesë për rivendosje në afat, kërkesë e cila duhet të shqyrtohet dhe të pranohet, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes (pika 1, e nenit 55, të ligjit 44/2015), duke i krijuar atij mundësinë për të marrë pjesë në kursin e specializuar për t’u pajisur me certifikatën e Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik.

Konstatohet se, në zbatim të dispozitivit të vendimit nr. 16, datë 24.02.2021, Bashkia Maliq me shkresën nr. 1277/1 prot., datë 12.03.2021, ka njoftuar Komisionerin se nga ana e institucionit është depozituar kërkesëpadia pranë Gjykatës kompetente kundrejt vendimit paralajmërues.

Përsa kohë vlefshmëria e Vendimit të Komisionerit është duke u shqyrtuar nga Gjykata, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, “*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*”, i ndryshuar, si dhe nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile, propozojmë që **të miratohet pezullimi i procesit të mbikëqyrjes në vazhdim**, për këtë rast deri sa Gjykata të shprehet me vendim të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Pezullimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 16, datë 24.02.2021, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë të procedurës së lirimit nga shërbimi civil për shkak të ligjit, të nëpunësit *****”, në detyrën “Specialist Auditi”.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni Bashkia Maliq dhe nëpunësi *****.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA